

MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Xhensila Pine, anëtare e trupit gjykues për subjektin e rivlerësimit, z. Ramazan Avdiu, kam votuar kundër marrjes së vendimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, duke parashtruar arsyetimin tim në pakicë lidhur me sa vijon:

Në datën 15.4.2021, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve u zhvillua seanca dëgjimore, ku subjekti i rivlerësimit i paraqiti trupit gjykues kërkesën për riçeljen e hetimit administrativ për arsye të një gabimi material të kryer nga Komisioni në analizën financiare dhe riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera.

Trupi gjykues pranoi kërkesën për riçeljen e hetimit me qëllim saktësimin e një gabimi material në pasqyrimin e gjendjes *cash* në analizën financiare dhe i dërgoi subjektit të rivlerësimit në datën 16.4.2021, tabelën e korigjuar të analizës financiare.

Në vijimin e seancës dëgjimore, në datën 26.4.2021, ora 14:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve, subjekti i rivlerësimit parashtroi: *“Unë, subjekti i rivlerësimit Ramazan Avdiu, pas seancës dëgjimore datë 15.4.2021, në të cilën paraqita disa kërkesa drejtuar jush, u njoha me vendimin për riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë për shkak të gabimit në pasqyrimin e gjendjes cash në analizën financiare të kryer prej jush.*

Jam njohur edhe me vendimin tuaj nr. 6, datë 15.4.2021, me rishikimin dhe ndryshimet e gjendjes cash në analizën financiare, pas korigjimit të gabimit material.

Korigjimi ka sjellë disa efekte në analizën financiare të periudhës 2003 – 20016, në të paktën 9 elementë të analizës financiare, si uljen e masës së mosmbulimit me burime të ligjshme të këtyre elementeve, gjithashtu, efektet direkte të korigjimit tek analiza sjellin ndryshim të rezultatit të hetimit nga vlera negative mosmbulim, në pozitive mbulim në të paktën 3 elementë dhe e afruar pothuajse afër 0 (zero) në shuma gati të papërfillshme negative në 2 elementë të tjerë të analizës financiare.

Pavarësisht këtyre pasojave direkte në rezultatit e hetimit nga ana juaj, në kundërshtim me procedurat e parashikuara në vendimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit në hapat procedurale të unifikuar, nuk është ribërë rezultati i hetimit administrativ, pra, hetimi administrativ ka mbetur i pambyllur dhe sërish janë dhënë më shumë në pamundësi se më parë për mbrojtjen time efektive, kjo për shkakun se tashmë unë nuk e di se cili është rezultati i hetimit dhe qëndrimi juaj në lidhje me ato elemente të rezultatit të hetimit që preken nga korigjimi juaj i gabimit material”.

Bazuar në sa më sipër, kam vlerësuar se pranimi i kërkesës së subjektit për rihapje të hetimit administrativ, dhe informimi i subjektit mbi rezultatit e rishikuar të hetimit administrativ do të ishte në respektim të udhëzimeve të GJEDNJ-së dhe do të garantonte që subjekti të mos vendosej në një gjendje të pafavorshme. Kjo, do të shërbente që të bëhej praktike dhe efektive mundësia e subjektit të rivlerësimit për të ushtruar të drejtat dhe për të lehtësohej pjesëmarrjen e tij reale në proces, duke parandaluar disavantazhin e tij.

Për të gjitha sa më sipër, duke mbajtur parasysh respektimin e një procesi të rregullt ligjor, kam votuar kundër marrjes së vendimit përfundimtar, në këtë fazë të hetimit, pasi në vlerësimin tim si anëtare në pakicë është e pamundur të arrihet në konkluzionin përfundimtar lidhur me kontrollin e vlerësimit të pasurisë pa iu dhënë më parë mundësia objektive e mbrojtjes, subjektit të rivlerësimit nëpërmjet mundësive të qarta, praktike dhe efektive për të ushtruar këtë të drejtë.

Xhensila PINE

Anëtare/në pakicë